

VENDIM
Nr. 685, datë 29.7.2015

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 932, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2015”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 16 shtohet pika 16.1, me këtë përmbajtje:

“16.1 Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, të parashikuar në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, por jo më shumë se 200 mjekë në vit. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus në masën 100 000 lekë në muaj. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Mjekët e kontraktuar sipas paragrafit të mësipërm nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.”.

b) Shtojca 2, e vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca 2

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2015

000 lekë

Nr	Spitalet	Nr. Punonjësve	600 (paga e shtesa)	601 (sigurime shoqërore shëndetësore)	602 (mallra e shërbime)	604	606	rezervë	Totali
1	Berat	393	230,590	38,000	162,300				430,890
2	Bulqizë	105	57,620	9,790	24,240				91,650
3	Delvinë	32	20,490	3,420	6,000				29,910
4	Devoll	57	33,465	5,640	11,200				50,305
5	Dibër	384	219,500	36,655	116,660				372,815
6	Elbasan	658	367,999	60,852	266,253				695,104
7	Fier	527	295,200	49,465	181,600				526,265
8	Gramsh	164	97,370	16,260	35,360				148,990
9	Gjirokastrë	261	158,941	25,942	119,633				304,516
10	Has	43	26,880	4,330	13,030				44,240
11	Kavajë	169	95,180	15,895	37,300				148,375
12	Kolonjë	135	74,310	12,400	21,100				107,810
13	Korçë	590	331,730	55,230	221,300				608,260
14	Krujë	177	104,640	17,470	32,190				154,300
15	Kuçovë	77	47,050	7,850	17,690				72,590
16	Kukës	324	180,000	30,390	121,600				331,990
17	Kurbin	99	56,870	9,500	27,230				93,600
18	Lezhë	280	162,660	27,150	108,500				298,310
19	Librazhd	209	121,700	20,300	51,000				193,000
20	Lushnjë	312	181,440	30,100	117,400				328,940
21	Malësi e Madhe	17	11,905	1,990	5,500				19,395
22	Mallakastër	39	23,420	3,840	11,340				38,600
23	Mat	203	111,690	18,650	49,420				179,760
24	Mirditë	153	85,980	14,355	30,700				131,035
25	Peqin	30	20,360	3,400	6,700				30,460
26	Përmet	134	74,965	12,685	26,130				113,780
27	Pogradec	255	144,050	23,890	82,260				250,200
28	Pukë	155	87,050	14,535	38,470				140,055
29	Sarandë	200	119,140	19,890	63,200				202,230
30	Skrapar	145	81,910	13,670	18,320				113,900
31	Shkodër	795	437,568	72,572	231,192				741,332
32	Tepelenë	171	96,930	16,180	25,220				138,330
33	Q.S.U.T	2,980	1,651,414	272,791	3,681,449				5,605,654
34	Mat.nr1	380	230,980	38,460	199,300				468,740
35	Mat.nr.2	286	180,180	29,920	151,650				361,750
36	Sanatoriumi	350	192,610	32,160	270,428				495,198
37	Tropojë	163	91,540	15,285	36,260				143,085
38	Vlorë	585	321,520	53,320	201,500				576,340
39	SU Trauma	332	221,230	36,945	350,500				608,675
	Paketat e shërbimeve		0	0	0	1,179,471			1,179,471
	trajtime me VKM		0	0	0	70,000			70,000
	Transferta per individë						40,000		40,000
	Rezerve e pashpërndarë		0	0	0			74,150	74,150
	TOTALI	12,369	7,048,077	1,171,177	7,171,125	1,249,471	40,000	74,150	16,754,000